

**KOMERCIJALNA BANKA AD
SKOPJE**

Nr. _____
Shkup, _____

MARRËVESHJE

Për urdhërpagesë të përhershme për kryerjen e pagesave nga llogaria e transaksionit të poseduesit të llogarisë

E lidhur më _____, ndërmjet:

1. Komercijalna Banka AD Skopje (në tekstin e mëposhtëm: Urdhër-pranues), e përfaqësuar nga Biljana Mitevaska – Drejtore e Drejtorisë së Pavarur të Qarkullimit Pagesor në vend, nga njëra anë dhe
2. _____, (në tekstin e mëposhtëm: Urdhërdhënës), e përfaqësuar nga _____

Neni 1

Me këtë Marrëveshje, Urdhërdhënësi me

Numër të llogarisë së transaksionit

Emërtimi i llogarisë së transaksionit

NUAQ/ Numri tatimor _____

Adresa e kontaktit _____

Kontakt telefoni _____

E autorizon urdhër-pranuesin – Bankën, në emër dhe për llogarinë e saj, të kryej pagesa nga mjetet në llogarinë e transaksionit të lartpërmendur, për:

PP30

Llogaria e transaksionit të pranuesit _____

Emri i pranuesit _____

Banka e pranuesit _____

Shuma _____

Baza-qëllimi i pagesës _____

Thirrje në numrin– ngarkim _____

Thirrje në numrin – miratim _____

Shifra e pagesës _____

PP50

Llogaria e transaksionit të pranuesit _____
Emri i pranuesit _____
Banka e pranuesit _____
Shuma _____
Baza - qëllimi i pagesës _____
Thirrje në numrin – ngarkim _____
Llogaria e pagesës _____
Llogaria e shfrytëzuesit buxhetor _____
Shifra e të ardhurave dhe programi _____

Detyrimi matoron për pagesë më:

Data e maturimit _____
Periudha e maturimit _____ (mujore, katërmujore, vjetore dhe ngjashëm.)
Këstet e maturuara _____

Neni 2

Urdhërdhënësi obligohet se në datën e theksuar për transferimin e mjeteve financiare sipas kësaj urdhërpagese, do të siguroj mjete të mjaftueshme për shlyerjen e detyrimit të theksuar, posaçërisht për shlyerjen e urdhërpagesës së përhershme në pajtim me Tarifën për kompensime dhe shërbime që i kryen Banka.

Neni 3

Urdhër-pranuesi – Banka do ta kryej pagesën nga llogaria e transaksionit të urdhërdhënësit deri në lartësinë e mbulesës së llogarisë. Me mbulesë të llogarisë së transaksionit nënkuptohet gjendja e llogarisë së transaksionit nga dita paraprake e punës, e zvogëluar për të gjitha pagesat e realizuara nga llogaria e transaksionit së bashku me provizionin bankar të parashikuar deri në momentin e verifikimit të saldës, kurse e zmadhuar me të hyrat e parapara të evidentuara të mjeteve të llogarisë në ditën rrjedhëse dhe shuma e miratuar por e pa shfrytëzuar e revolving kreditit.

Член 4

Urdhër-pranuesi – Banka do të realizoj pagesa në bazë të urdhërpagesës së përhershme në datën e maturimit të shënuar më lartë. Nëse data përfundimtare e pagesës bie ditë jo pune, pagesa do të bëhet ditën e parë vijuese të punës. Nëse në këtë datë në llogarinë e transaksionit nuk ka mjete të mjaftueshme për pagesa sipas urdhërpagesës, i njëjti e merr statusin e pritjes dhe me hyrjen e parë të mjeteve financiare, sipas radhës së realizimit të urdhërpagesave, i njëjti do të realizohet.

Neni 5

Banka nuk mban përgjegjësi për interesin e vonuar nga Pranuesi i mjeteve dhe çdo detyrim tjetër nëse, në përpjekjen e parë dhe në datën e fundit të maturimit, nuk ka mbulim të mjaftueshëm në llogarinë e transaksionit.

Neni 6

Banka është e detyruar, që rregullisht t'i kryejë pagesat sipas kësaj urdhërpagese, në llogari të poseduesit të llogarisë së transaksionit.

Neni 7

Urdhërdhënësi obligohet se do t'i kryejë shërbimet që dalin nga kjo dhe mbi bazë të kësaj Marrëveshje dhe t'i paguajë Bankës – Urdhër-pranuesit një tarifë në shumën, sipas afateve dhe mënyrës në pajtim me tarifën për kompensime për shërbimet e kryera nga Banka. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Urdhërdhënësi e autorizon Bankën dhe i lëshon asaj një urdhërpagesë të paravokueshme për t'i paguar kompensimet dhe shpenzimet sipas qëndrimit paraprak në ngarkesë të llogarisë.

Neni 8

Kjo Marrëveshje lidhet në afat të pacaktuar. Të njëjtën mund ta prishe njëra nga palët, në rastet si në vijim:

- Urdhër-marrësi – Banka mund ta prish këtë Marrëveshje nëse në llogarinë e transaksionit nuk do të ketë mjete financiare për realizimin e urdhërpagesës për dy këste me radhë, me çka Marrëveshja për urdhërpagesën e përhershme do të konsiderohet e pavlefshme.
- Urdhërdhënësi, me një afat prej 5 ditësh para datës së ekzekutimit të pagesës, ta njoftoj Bankën nëse kryen ndryshime të instruksioneve të dhëna paraprakisht, përkatësisht nëse tërësisht e anulon Marrëveshjen për urdhërpagesë të përhershme.

Neni 9

Për gjithçka që nuk është paraparë me këtë Marrëveshje vlejnë rregullat e dispozitave ligjore dhe aktet e politikës afariste të Bankës.

Neni 10

Në rast të mosmarrëveshjeve, kompetente është Gjykata në Shkup.

Neni 11

Marrëveshja është përpiluar në dy (2) ekzemplarë identik, nga një për secilën palë.

Neni 12

Marrëveshja është lidhur dhe hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

POSEDUESI I LLOGARISË

**KOMERCIJALNA BANKA AD
SHKUP**

(vula dhe nënshkrimi i personit të autorizuar)
